

Prezantim në Workshopin e realizuar për komunitetin e personave trangjinorë në Shqipëri:

- Gjendja e personave trans në Shqipëri është shumë larg gjendjes së përgjithshme të komunitetit LGB. Përjashtimi i komunitetit trans nga jeta familjare, shoqërore dhe ekonomike ka qenë dhe mbetet një nga pasojat me kritike të homofobisë dhe transfobisë në Shqipëri.
- Në përpjekjet për të forcuar komunitetin LGBT në këto vite, është parë se nevojat e personave trans, janë të një spektri shumë më të gjerë dhe të një natyre shumë më të komplikuar se sa ato të komunitetit LGB. Kjo nuk i bën ato më pak të zgjidhshme se sa problemet dhe nevojat e komunitetit LGB por kërkon një impenjim serioz dhe të dedikuar ndaj kësaj çështje. Këtu kemi parasysh numrin e madh të problemeve të komunitetit trans si pasojë e vizibilitetit të tyre në shoqëri dhe mosnjohjes së çështjeve të identitetit gjinor në vend.

Në njërin krah janë nevojat primare si

- mbrojtja nga dhuna, diskriminimi i shumëfishtë;
- ndërhyrjet për raste emergjente pranë institucioneve të ndryshme;
- komunikimi i përditshëm për tu njohur me problemet e tyre, apo qoftë edhe për të folur me ta;
- diskriminimi dhe veçimi i personave trans brenda vetë grupit LGB etj
- dhe në anën tjetër studimi dhe njohja e çështjeve ligjore, psiko-sociale dhe ato që lidhen me shëndetin, politikat dhe praktikat më të mira në lidhje me integrimin e plotë të personave trans në shoqëri.

Siç mund të merret me mend dhe kuptohet situata sot me komunitetin trans është ende shumë problematike dhe ka ende shumë për të bërë. Në 20 vitet e fundit, një grup shumë i vogël njerëzish kanë shfaqur një sens të të qënurit mashkull apo femër që nuk ka korresponduar me pamjen e tyre të jashtme. Për pasojë ata kanë vuajtur hapur diskriminimin e shumëfishtë, dhe gjithë pasojat e imagjinueshme të tij. Një nga pasojat më të rënda është që shumë persona trans detyrohen të jenë punonjës seksi si të vetmen mënyrë fitimi dhe mbijetese. Raportet e tre viteve të fundit të Ambasadës PINK mbi shkeljen e të drejtave LGBT tregojnë se mesatarisht 8 në 10 raste diskriminimi janë të raportuara nga ky komunitet.

Aktet kanë qenë të ndryshme të tilla si:

- Rrefuzimi për tu ofruar shërbim mjekësor, (theksojmë këtu raste urgjente);
- Sulme fizike nga grupe të rinjsh, punonjës të policisë dhe klientë të tyre;
- Arrestime të shpeshta dhe praktika jo të përshtatshme hetimi nga forcat e policisë;
- Dëmtim i pronës apo mjediseve ku jeton ky komunitet; (Prill 2011);

- Gusht 2011, një person trans vuajti dhunë të pajustificuar nga 6 punonjës policie në rrugë dhe më pas në rajon pasi refuzoi ti bindej një punonjësi të policisë;
- Dhunë në mjedisin familjar dhe dëbim nga shtëpia;
- Vendime gjyqësore të padrejta - Një person i vetëidentifikuar si transgjinnor, pas divorcit më bashkëshorten e tij iu lejua koha minimale për të parë vajzën e tij, pra vetëm 2 herë në muaj edhe pse ai kishte shprehur dëshirën për ta takuar çdo jave dhe pavarësisht se ai nuk përbënte rrezik për vajzën e tij.
- Këtë dimër PINK reagoi për dënimin jo-proporcional dhe diskriminues të dy personave trans nga Gjykata e Tiranës.
- 2009 është rregjistruar edhe vrasja e parë kundër një personi trans, të cilin autoritetet nuk e gjykuan si rast krimi urrejtje.

- CFARË MUND TË BËHET:

- Ashtu siç janë përpjekur organizatat LGBT në 4 vitet e fundit, duhet që masat të fillojnë me një program të gjerë ndërgjegjësues dhe informues specifik për komunitetin trans dhe të drejtat trans. Policia, shërbimet sociale dhe shëndetësore, gjyqësori, mediat dhe shkollat duhet të jenë të gjitha pjesë e tij;
- Parandalimi i diskriminimit është i rëndësishëm: Siç kuptohet diskriminimi dhe paragjykimi mbeten probleme të medha dhe për këtë arsye duhet një implementim i plotë i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, respektimi dhe promovimi i të drejtave të komunitetit trans. Institucionet përgjegjëse për implementimin e ligjit duhet të ndërgjegjësohen ndër të tjera edhe për të drejtat e personave trans;
- Situata ligjore duhet të ndryshojë për njohjen e të drejtave të komunitetit trans përmes studimit të situatës ligjore aktuale dhe implementimit të praktikave më të mira nga vende të tjera. Koordinimi me organizatat LGBT në Shqipëri dhe Europë me qeveri apo institucione ndërkombëtare që kanë punuar në këtë fushë.
- Pushteti lokal duhet të punojë për identifikimin e problemeve dhe nevojave primare të komunitetit trans të cilat vijnë për shkak të diskriminimit dhe veçimit të kahershëm në mënyrë që ky komunitet të gëzojnë shërbimet parësore që lidhen me nevojat e tyre. Rëndom personave trans u mohohen shërbimet minimale si aksesimi në lokale dhe bare, shërbime mjekësore, ato të mbrojtjes nga dhuna dhe diskriminimi etj. Për këtë arsye stafet e bashkive dhe ato të policisë duhet të informohen dhe ndërgjegjësohen për çështjet trans, nevojat e këtij komuniteti dhe praktikatat më të mira anti-diskriminim.
- Bashkia e Tiranës duhet të miratojë urgjentisht një plan pune ku të adresojë problemet kryesore të personave trans dhe të ofrojë zgjidhje të përshtatshme dhe afatgjata të tilla si:
 - Sigurimi i një qëndre pritesë dhe strehuese;
 - Ofrimi i shërbimeve psikosociale dhe mbështetëse brenda këtyre qendrave me punonjës socialë të trajnuar dhe përgatitur posaçërisht për nevojat e këtij komuniteti;
 - Sigurimi i strehimit afatgjatë të personave trans duke nisur nga rregjistrimi i tyre si persona të pastrehë;

- Caktimi në buxhetin vjetor i shumave specifike duke marrë për bazë gjendjen aktuale dhe nevojat e komunitetit trans;
- Bashkëpunim dhe koordinim me organizatat LGBT dhe institucionet qëndrore për programe trajnimi, ndërgjegjësimi dhe implementimi të një plani strategjik realist, afatgjatë dhe vizionar nga Bashkia e Tiranës, në mënyrë që ai të shërbejë si një plan pilot dhe të jetë i përdorshëm edhe nga bashki më të vogla në rastet kur të lindë kjo nevojë;
- Përveç përpjekjeve aktuale për mosdiskriminimin në mjedisin e punës për shkak të identitetit gjinor duhet punuar që komuniteti trans të fuqizohet duke marrë dy hapa të rëndësishme:
 - Caktimin e punësimit të personave trans si prioritet
 - inkurajimin dhe mbështetjen e iniciativave për vertpunësim të komunitetit trans.
- Personat trans duhen asistuar dhe ndihmuar për të marrë në dorë fatin e tyre, me programe për rritjen e kapaciteteve organizative dhe advokuese në mënyrë që ata vetë të kërkojnë të drejtat e tyre. Duke marrë parasysh faktin se ky komunitet është shumë i vogël në Shqipëri dhe ekzistencën e tre organizatave LGBT duhet punuar që të ketë një koordinim për fuqizimin e këtij grupi në mënyrë efektive, më pak kosto dhe rezultate afatgjata;
- Rekomandimi ynë është gjithashtu që puna e bërë deri tani në kuadër të planit të masave të jetë sa më i detajuar dhe specifik në raport me nevojat dhe kërkesat e komunitetit trans duke patur parasysh vizibilitetin dhe qartësinë e kërkesave të tyre dhe të gjitha obligimet që burojnë nga legjislati në fuqi dhe konventat ndërkombëtare të Shqipërisë.